

R. II-246

Komisioni Kombjar

Shqiptar

“SHQIPJA,,



Ndë Vlorë

— Shtypëshkronja e Shtetit Shqypëtar —

1914

.....

**Komisioni Kombjar**

**Shqiptar**


**“SHQIPJA,,**



**Ndë Vlorë**

— Shtypëshkronja e Shtetit Shqypëtar —

**1914**



## Komisioni.

Polo Meksi Tepelena, Gjerq Çako Tepelena, Ahmet Durmish Vlora, Çeno Shara Vlora, Omer Abas Delvina, Namik Selim Delvina, Mehdi Borshi Himara, Osman Koka Kurveleshi, Bexhet Shapat Gjinokastra, Xhevdet Selfo Gjinokastra, Alush Taka Konispoli, Shahin Harum Vlora.

Arkëtar Shahin Harum, Shkruës Th. P. Pano.

Nr.inv. R-246



Nr. Inv. R. II-246  
Inv. br. 344 | 286



# Komisioni Kombjar Shqiptar “ SHQIP JA ,”

Nga të bëmet e të këqijat mynxore prej komitavet edhe ushtrivet greke ndë Shqipëri të Jugës, njerëzia e atyre vëndevet e ardhur nga prishëla ndë Vlorë si dhë njerëzia e këti qytezi e të krahinavet së 'tij bashkuar ndë një dhëmbje e fare e dishpruare ndë ditët të 26 të Prillit 1914 ndë një mbledhje në fushë të Vlonës, vendosi të formuarit të një komisioni prej 30 veta shqiptarë që të kujdeset për gjallësinë dhe të drejtat e njerëzisë si dhe për shpëtimin e Shqipërisë së Jugës.

Nesret në 27 komisioni i të 30, tuke parë shumicën e panevojme e për lehtësi të punësë, sgjodhi nga veht' e tij 12 vete e bashkatën e 'tyre e emeroj *Komisioni kombjar Shqiptar “Shqipja”*.

Ndë këtë komisjon janë të emëruar këta: Z. Z. Gherq Çako Tepelena, Polo Mekshi Tepelena, Ahmed Durmish Vlora, Çeno Shara Vlora, Omer Abas Delvina, Namik Selim Del-

vina, Mehdi Borshi Himara, Osman Koka Kurveleshi Bexhet Shapati Ghinakastra, Xhevdet Selfo Ghinokastër, Alush Taka Konispoli, Shahin Harum Vlora,

Ky komision punon me këtë statutë.

## STATUTË

### E Komisionit Kombëtar Shqiptar Ndihmor

#### “ SHQIPJA „

Nyji 1. Komisioni Kombëtar Shqiptar “ SHQIPJA „ trajtuar ndë Vlorë, si duket ndë shkrimet e të 26 e 27 Prillit ka për qëllim *mprojijen e të drejtavet* të njerëzisë si dhe *shpëtimin e vëndëvet* të *Shqipërisë* së Jugës për jetim *Shqiptar*.

Nyji 2. Komisioni qendrën e ka në Vlorë.  
Eshtë formuar nga 12 mise e nga këta: një kryetar, një arkëtar e një shkruës.  
Bën dega të 'tij ndë Shqipëri a gjetkë, e merret vesh me të tjera instituta ndihmëse.

Nyji 3. Qellimin e 'tij e bën me të ndihur e të dërguar luftarë ndënë kumandë të

xhandarmërisë ndë fushë të luftes.

Nyji 4. Fond' i Komisionit bëhet me ndihmat nga para edhe nga gjërra të dhuruara prej dashëmirëvct.

Nyji 5. Ky fond përdoret ndë të ndihur të luftarëvet me bukë e me gjërra rrnese, ndë të kujdesur të plagosurvet nga lufta, si dhe të prishuret nga zjarri e nga prêja dhe me spitale, shëruës e barëra, dhe në të përbajtun të fëmijëvet të deshmorëvet të luftës.

Nyji 6. Komisioni kshillimet e 'tij i mbân veçan.

Nyji 7. Kryetari qeverris punët e Komisionit-kujdeset vendimet me shumicë, të shkruarit e tyre dhe kqyr detyrat e arkëtarit dhe të shkruësit.

Nyji 8. Arkëtari mbam librat e fondavet.

Nyji 9. Shkruësi mban librat e kshillimevet e kopjet e korespondencës së komisionit.

Nyji 10. Komisjoni hap korespondencë për qëllimin e 'tij me kë e gjykon mirë.

Nyji 11. Ka vulë rrrotullare me fjalët ndë rreth *Komisione Kombjare Shqiptar*, ndë mes fjalën "Shqipja," Vitin 1914 edhe emërin e qytetit tek u fiullua

Nyji 12. Vulën e përdor Kryetari, i cili nënëshkruan e pret dhe korespondencën pas statutës.

Nyji 13. Komisioni dërgon në misionë miset e 'tij tek kupëton mirë e ndë vënt të tyre emëron si ndëkëmbës nga të 30-të.

Nyji 14. Komisjoni kûr sheh nevojë miret vesh me qeverinë.

Nyji 15. Shkruësi kâ votë ndë kskillime të komisionit.



